



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2025

ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Ekonomi

24 qershor 2025

Varianti A

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

|                     |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |
|---------------------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Pyetja              | 1  | 2  | 3  | 4  | 5  | 6  | 7  | 8  | 9  | 10 |
| Alternativa e saktë | C  | A  | C  | A  | C  | D  | C  | A  | B  | D  |
| Pyetja              | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| Alternativa e saktë | A  | C  | B  | C  | D  | B  | A  | A  | C  | A  |

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

Pyetjet me zhvillim

**Shënim:** Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21

Model përgjigjeje:


- 1) Sistemi i çmimeve. Çmimet përcaktohen nga oferta dhe kërkesa në treg, duke shërbyer si burim informacioni, burim shpërndarës dhe burim nxitës.
- 2) Konkurrenca, e cila nxit novacionin, përmirëson cilësinë e produkteve dhe mban çmimet të balancuara, duke sjellë përfitime si për bizneset ashtu edhe për konsumatorët.
- 3) Aftësia sipërmarrëse, ku individët me ide dhe vizion ndërmarrin rreziqe për të krijuar dhe menaxhuar biznese të reja.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** nëse shpjegon dy shtylla të sipërmarrjes së lirë.  
**1 pikë** nëse shpjegon një shtyllë të sipërmarrjes së lirë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22****Model përgjigjeje:**

- 1) Çmimi ekuilibër do të jetë 5000 lekë/biletë, sepse për këtë çmim, sasia e kërkuar barazohet me sasinë e ofruar.
- 2) Nëse çmimi i vendosur nga organizatorët do të jetë 4000 lekë, do të mbeten pa biletë:  $2\ 500 - 2\ 100 = 400$  individë.
- 3) Grafiku

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.  
**2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.  
**1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23****Model përgjigjeje:**

- 1) Emetimi i monedhës.
- 2) Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare.
- 3) Mbikëqyrja e sistemit monetar.
- 4) Shërben si bankë për bankat e nivelit të dytë.
- 5) Shërben si bankë për qeverinë.
- 6) Ruajtja e rezervave valutore dhe ato të arit.
- 7) Sigurimi i funksionimit normal të sistemit të pagesave.
- 8) Etj.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse formulon saktë tre funksione të Bankës së Shqipërisë.  
**2 pikë** nëse formulon saktë dy funksione të Bankës së Shqipërisë.  
**1 pikë** nëse formulon saktë një funksion të Bankës së Shqipërisë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24****Model përgjigjeje:**

- 1) Barazimi kontabël: Aktiv = Pasivi (Mjetet) = Detyrime + Vlera neto e firmës
- 2) Shuma e Aktivit = mjete qarkulluese + inventari + makineri dhe pajisje + ndërtesa  

$$= 10\ 000\ € + 10\ 000\ € + 50\ 000\ € + 80\ 000\ € = 150\ 000\ €$$
- 3) Vlera neto e firmës = Mjete – Detyrime =  $150\ 000\ € - 100\ 000\ € = 50\ 000\ €$

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.  
**2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.  
**1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25****Model përgjigjeje:**


- 1)  $ATC_4 = TC_4 / Q_4 = 460 / 4 = 115$  njësi paraje
- 2)  $MC_2 = \Delta TC / \Delta Q = (TC_2 - TC_1) / (Q_2 - Q_1) = (320 - 270) / (2 - 1) = 50 / 1 = 50$  njësi paraje
- 3)  $AFC_5 = TFC_5 / Q_5 = 200 / 5 = 40$  njësi paraje
- 4)  $AVC_6 = TVC_6 / Q_6 = (TC_6 - TFC_6) / Q_6 = (670 - 200) / 6 = 470 / 6 = 78.3$  njësi paraje

**Nxënësi fiton:**

- 4 pikë** nëse përgjigjet saktë për katër kërkesat.  
**3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.  
**2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.  
**1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 26****Model përgjigjeje:**

- 1) Kërkesa për tokë bujqësore që përdoret për prodhimin e produkteve organike do të rritet.
- 2) Çmimi i tokës bujqësore (Renta) do të rritet.
- 3) Paraqitja grafike

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.  
**2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.  
**1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 27****Model përgjigjeje:**

Pro

- 1) Rritja e shpenzimeve publike mund të nxisë punësimin dhe rritjen ekonomike.
- 2) Në një periudhë recensionit, deficit buxhetor mund të ndihmojë ekonominë të rimëkëmbet.
- 3) Borxhi i publikut i shprehur në % ndaj PBB-së nuk do të përbëjë shqetësim nëse do të jetë në nivele të arsyeshme, si për shembull më i vogël ose i barabartë me 60%.

Kundër

- 1) Deficitet e larta mund të na çojnë në një rritje të borxhit publik, duke e bërë më të vështirë financimin e shpenzimeve të ardhshme.
- 2) Deficiti buxhetor mund të shkaktoj rritje të normës së interesit, duke bërë më të shtrenjtë marrjen e kredisë për bizneset dhe familjet.
- 3) Kur qeveria merr borxh për të financuar deficitin e saj ajo mund të pakësojë fondet që mund të përdoren prej bizneseve për investime. Pra deficitet buxhetore ulin investimet private.
- 4) Nëse qeveria do të shtypë para për të financuar deficitet e larta dhe për të pakësuar borxhet kjo do të rriste sasinë e parave në qarkullim dhe do të rriste çmimet. Për rrjedhojë mund të na çojë në inflacion.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse formulon një argument pro dhe dy kundër për deficitin buxhetor dhe borxhin publik.
- 2 pikë** nëse formulon një argument pro dhe një kundër për deficitin buxhetor dhe borxhin publik; nëse formulon dy argumente kundër për deficitin buxhetor dhe borxhin publik.
- 1 pikë** nëse formulon një argument pro për deficitin buxhetor dhe borxhin publik; nëse formulon një argument kundër për deficitin buxhetor dhe borxhin publik;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 28****Model përgjigjeje**

- 1) Pagat e punonjësve; Të ardhurat nga interesat
- 2)  $GDP = C + I + G + (EX - IM) = 90 + 30 + 60 + (20 - 40) = 160$  milionë lekë
- 3) Ndihma sociale

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.
- 2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.
- 1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 29****Model përgjigjeje:**

- 1) % e ndryshimit në çmim është:  $\% \Delta P = \frac{P_2 - P_1}{(P_1 + P_2)/2} \times 100 = \frac{600 - 400}{(400 + 600)/2} \times 100 = 40\%$

2) % e ndryshimit në sasinë e kërkuar është 50 % sepse

$$\% \Delta Qd = \frac{Qd_2 - Qd_1}{(Qd_1 + Qd_2)/2} \times 100 = \frac{6000 - 10000}{(10000 + 6000)/2} \times 100 = -50\% . \text{ Sasia ka ndryshuar me } 50\%$$

3)  $Ed = \% \Delta Qd / \% \Delta P$ ; Elasticiteti i kërkesës në këtë rast është  $50\% / 40\% = 1,25$ ;

$$|Ed| = \frac{\frac{Qd_2 - Qd_1}{(Qd_1 + Qd_2)/2}}{\frac{P_2 - P_1}{(P_1 + P_2)/2}} = \frac{0,5}{0,4} = 1,25$$

4) Meqenëse  $Ed = 1.25$  dhe është  $> 1$  kërkesa është elastike.

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse përgjigjet saktë për katër kërkesat.

**3 pikë** nëse përgjigjet saktë për tre kërkesat.

**2 pikë** nëse përgjigjet saktë për dy kërkesat.

**1 pikë** nëse përgjigjet saktë për një kërkesë.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 30

#### Model përgjigjeje

a) Ndjekja e një politike monetare shtrënguese do ndikojë në uljen e ofertës monetare.

b) Instrumentet monetare që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit janë:

- 1) Rritja e normës së rifinancimit/norma e skontos, në mënyrë që bankat e nivelit të dytë të mos marrin shumë kredi nga Banka Qendrore.
- 2) Rritja e normës së rezervës së detyrueshme bankare, që bankat të mbajnë në gjendje para dhe të mos japin shumë kredi.
- 3) Shitja e bonove të thesarit në mënyrë që të tërheqë para nga qarkullimi.
- 4) Rritja e normës bazë të interesit, në mënyrë që kreditë të shtrenjtohen.
- 5) Kontrolli i kredisë/ulja e kufirit të kredisë në mënyrë që të ulet oferta monetare.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse përcakton ndikimin e politikës monetare shtrënguese në ofertën monetare dhe analizon dy instrumente që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit.

**2 pikë** nëse përcakton ndikimin e politikës monetare shtrënguese në ofertën monetare dhe analizon një instrument që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit; nëse analizon dy instrumente që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit.

**1 pikë** nëse përcakton ndikimin e politikës monetare shtrënguese në ofertën monetare; nëse analizon një instrument që përdor Banka Qendrore për të ulur normën e inflacionit.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 31****Model përgjigjeje:**

- Lexon duke kuptuar- Ana duhet të lexojë me vëmendje dokumentet që lidhen me mbarëvajtjen e punës së saj.
- Përcjell idetë me shkrim- të shkruajë raporte të qarta për ecurinë e punëve në zyrë.
- Flet në mënyrë që të tjerët të kuptojnë duke komunikuar qartë idetë në funksion të qëllimit të punës.
- Dëgjon në mënyrë aktive- tregon vëmendje ndaj asaj që thuhet.
- Vrojton me kujdes- tregohet e vëmendshme ndaj informacionit pamor për mbarëvajtjen e punës.
- Përdor matematikën për të zgjidhur probleme të përditshmërisë në punë.
- Planifikon veprimtaritë për menaxhimin financiar, shërbimin ndaj klientëve dhe strategjitë e marketingut.
- Zgjidh probleme dhe merr vendime në shërbim të klientëve.
- Bashkëpunon me stafin për arritjen e objektivave.
- Përkrah dhe ndikon te stafi duke bërë ndryshime nëse është e nevojshme
- Zgjidh dhe negocion konfliktin midis palëve të përfshira.
- Udhëzon dhe punon bashkërisht me stafin për të përcaktuar zgjidhjen më të mirë.
- Reflekton dhe vlerëson mbi rezultatet, arritjet e punës.
- Mëson nëpërmjet kërkimit, mbledh dhe analizon informacionet për vijimësinë e proceseve të punës.
- Përdor teknologjinë e informacionit dhe te komunikimit për menaxhimin financiar dhe strategjitë e marketingut.
- Merr përgjegjësi për të mësuar në vazhdimësi.

**Shënim:** nxënësit vlerësohet nëse i përmbahet 16 aftësive për sukses duke i përshtatur përgjigjet në funksion të situatës së dhënë në pyetje.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse shpjegon saktë tri aftësi për të patur sukses në punë.  
**2 pikë** nëse shpjegon saktë dy aftësi për të patur sukses në punë.  
**1 pikë** nëse shpjegon saktë një aftësi për të patur sukses në punë.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32****Model përgjigjeje:**

- 1) Sipërmarrëse e informuar- e ndikuar nga familja ajo ka marrë informacionin e duhur.
- 2) Produkti i duhur- produkte të diferencuara nga konkurrentë.
- 3) Përparësi konkurruese- produkte cilësore.
- 4) Plani i etikës- produktet e kozmetikës nuk testohen tek kafshët dhe nuk kanë elementë kimikë të dëmshëm.
- 5) Tregu i duhur- ajo zgjeroi aktivitetin në tregun ndërkombëtar.
- 6) Etj.

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse shpjegon saktë tre elementë për një sipërmarrje të suksesshme.  
**2 pikë** nëse shpjegon saktë dy elementë për një sipërmarrje të suksesshme.  
**1 pikë** nëse shpjegon saktë një element për një sipërmarrje të suksesshme.  
**0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 33****Model përgjigjeje:**

- 1) Dimë që në konkurrencë të plotë  $MR = P$  meqenëse  $P = 34$  edhe  $MR = 34$  njësi paraje
- 2) Meqenëse na jep  $ATC = 32$  dhe  $ATC = TC / Q$  atëherë  $TC = ATC \times Q$   
 $TC = 32 \times 6400 = 204.800$  njësi paraje
- 3) Fitimi =  $TR - TC$ ,  $TR = P \times Q = 34 \times 6400 = 217.600$ , fitimi =  $217.600 - 204.800 = 12.800$  njësi paraje

**Nxënësi fiton:**

- 3 pikë** nëse llogarit saktë tre treguesit ekonomikë.
- 2 pikë** nëse llogarit saktë dy treguesit ekonomikë.
- 1 pikë** nëse llogarit saktë një tregues ekonomikë.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.